

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE

“URAVERDE” shpk

Në Tiranë, sot me datë 26/10/23, hartohet dhe nënshkruhet ky akt për themelimin e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar nga ortakët themelues:

Fabian Banushi, i biri i Luanit, i datëlindjes 14.03.1987, lindur e banues në Tiranë, Rr.”Nikolla Tupe”, P.4, nr.8, mbajtës i kartës së identitetit I70314064H.

Francesco Bifulco, i biri i Antonios, datëlindja 10.05.1978, lindur në Napoli Itali dhe banues në Tiranë, Rr.”Nikolla Tupe”, P.4, nr.8, mbajtës i pasaportës YB2716813.

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria tregtare që krijohet ka emrin “URAVERDE” shpk. Ky emër do të vendoset në çdo shkresë dhe do të përdoret në marrëdhëniet me personat e tretë.

Neni 2
Selia

Shoqëria “URAVERDE” shpk e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në qytetin e Tiranës në adresën Rr.”Nikolla Tupe”, P.4, nr.8. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakut të ortakëve.

Neni 3
Forma juridike

Shoqëria “URAVERDE” shpk krijohet në formën e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në të cilën ortakët përballojnë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.



Neni 4

Personalitetin juridik, shoqëria e fiton mbas regjistrimit të saj në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, ndërsa aktiviteti tregtar të saj e fillon mbas regjistrimit në organet tatimore.

Neni 5 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë “URAVERDE” shpk është për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Ky afat mund të ndryshojë ose të ndërpritet me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, nga shumica e ortakëve, të cilët përfaqësojnë jo më pak se $\frac{3}{4}$ e kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë tregtare “URAVERDE” shpk është 100.000 (një qind mijë) lekë dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Kapitali themeltar ndahet në 2 (dy) kuota me vlerë nominale si në vijim:

1 në vlerën 51.000 (pesëdhjetënjë mijë) lekë dhe

1 në vlerën 49.000 (dyzetënëntë mijë) lekë.

Një kuotë, përveç vlerës nominale të saj, ka edhe vlerën e një vote në Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve.

Në momentin e krijimit të shoqërisë, kapitali themeltar prej 100.000 (një qind mijë) lekë është paguar tërësisht nga ortakët themelues 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) lekë nga Fabian Banushi dhe 49.000 (dyzetënëntë mijë) lekë nga Francesco Bifulco. Në bazë të kontributit të paguar, pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar është:

Fabian Banushi zotëron 51% të kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë me vlerë 51.000 (dyzetegjashtë mijë) lekë.

Francesco Bifulco zotëron 49% të kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuotë me vlerë 49.000 (dyzetënëntë mijë) lekë.

Neni 7 Objekti i shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare “URAVERDE” shpk është:

Eksport-import dhe tregtim të ulla të tregtisë dhe nënprodukteve të tij, si dhe të produkteve të tjera bujqësore.

Neni 8 Organet drejtuese

Organi më i lartë drejtues dhe vendim-marrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve, e cila harton politikën dhe zhvillimin e veprimtarisë ekonomike dhe drejton e mbikëqyr këto veprimtari.



Asambleja e ortakëve ushtron kompetencat nëpërmjet vendimeve, që merren prej saj. Vendimet e asamblesë merren sipas kuorunit të kërkuar për çështje të caktuara, kuorum, i cili përcaktohet në Statut.

Neni 9 Administrimi

Shoqëria tregtare “URAVERDE” shpk drejtohet nga një administrator, i cili në mënyrë individuale ka të drejtë të ushtrorë të gjitha kompetencat dhe veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Emërtimi, mandati, të drejtat dhe detyrat e administratorit përcaktohen në Statut dhe akte të tjera të brendshme të shoqërisë.

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, **Fabian Banushi**. Administratori **Fabian Banushi** është përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 10 Viti financiar

Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë ndahet në periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon me datë 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik, me përjashtim të vitit të parë, i cili fillon nga data e krijimit të shoqërisë dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 11 Bilanci financiar

Shoqëria mban dokumentacionin e nevojshëm financiar për administrimin e pasurisë dhe për zhvillimin e të gjithë veprimtarisë së saj, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës në fuqi. Bilanci financiar i shoqërisë përpilohet në bazë të raportit me shkrim të ekspertit kontabël të autorizuar dhe të raportit të paraqitur nga administratori brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Raporti paraqitet dhe miratohet në Asamblenë e Ortakëve brenda datës 30 Qershor.

Fitimi neto i shoqërisë llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme të vitit të mëparshëm, shlyerja e të gjithë detyrimeve fiskale dhe ndaj çdo personi të tretë, si dhe fondet financiare që përbëjnë rezervën e detyrueshme.

Fitimi neto ndahet midis ortakëve, në bazë të përqindjes së kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 12 Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

Veprimtaria e shoqërisë mbaron me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, në rastet kur veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurëse apo edhe për shkaqe të tjerë të njohur ligjorë. Në këtë rast shoqëria kalon në likuidim.

Likuidimi i shoqërisë bëhet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Të ardhurat që rezultojnë nga likuidimi i shoqërisë, mbas shlyerjes së të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, ndahen midis ortakëve në përpjestim me pjesën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 13
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Si rregull, çdo mosmarrëveshje ortakët do ta zgjidhin me mirëkuptim midis tyre. Në rast të kundërt, ata kanë të drejtë të ngrenë padi për zgjidhjen e tyre në Gjykatën e shkallës së parë Tiranë.

Neni 14
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi hartohet në 3 (tre) ekzemplarë të njëjtë dhe nënshkruhet nga ortakët themelues. Originaliteti i këtyre ekzemplarëve dhe nënshkrimet e ortakëve vërtetohen nga ana e noterit.

Ortakët Themelues të Shoqërisë

“URAVERDE” shpk

FABIAN BANUSHI

FABIAN

BANUSHI



FRANCESCO BIFULCO



FRANCESCO BIFULCO